REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 049/26 Dt. 02.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 7 dhe 9 të Rregullores MF-nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së menaxheres për zhvillimin e kapaciteteve në Asociacionin e Komunave të Kosovës -AKK, kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
## Për Themelimin e Grupit

1. Themelohet Grupi i përfaqësueseve nga Komuna e Prizrenit për zbatimin e aktiviteteve të parapara me Projektin ReLOaD3, në këtë përbërje:

   1.1 Lulzim Sylejmani,.......Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF). Lulzim.N.Sylejmani@rks-gov.net, tel. +38348263917.

   1.2 Mehreme Gërguri Krasniqi.....përfaqësuese nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mehreme.Gerguri@rks-gov.net, tel. +38349475288.

2. Grupi i përfaqësueseve nga Komuna do të fillojnë bashkërisht zbatimin e aktiviteteve të parapara me projektin ReLOaD3 në përputhje me nenin 7 dhe 9 të Rregullores MF-nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve si dhe metodologjinë LOD, ekipi i projektit do të bashkëpunoj gjatë gjithë fazave të zbatimit të projektit; do të njoftoj rregullisht Kryetarin me ecurinë e aktiviteteve të projektit si dhe do ti kryej edhe punët tjera që kërkohen me projektin e cekur.

3. Grupi i përfaqësueseve për zbatimin e aktiviteteve të parapara të projektit ReLOaD3 ka për obligim që të bashkëpunoj me ekipin e projektit gjatë gjithë fazave të zbatimit.

4. Anëtarët e Grupi të përfaqësueseve do të kenë rol në Komisionin vlerësues të projekt -propozimeve në Komisionin e ankesave dhe ne Komisionin për monitorimin dhe raportimin të projekteve.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Anëtarëve të Grupit,
- Lindita Ymeri-AKK,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 052/26 Dt. 03.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e realizimit të projektit: "Plani pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave", "Plani lokal i veprimit në mjedis", "Plani për biodiversitet", "Plani lokal për strategji të cilësisë së ajrit", dhe "Rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba" të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike-mallra dhe shërbime.

3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Sektorit të Prokurimit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 050/26 Dt. 03.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova 01 nr. 636 datë, 02.10.2023 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për lejimin e mjeteve për bashkëfinancim**

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e mjeteve financiare për bashkëfinancim në realizimin e projektit: "Bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara arsimore në sistemin e rregullt arsimor", i cili bashkëfinancim është i bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova 01 nr. 636 datë 02.10.2023, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt (kësti i fundit), lejon mjetet financiare në shumë prej 5,060.00 € (pesë mijë e gjashtëdhjetë euro).

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova 01 nr. 636, datë 02.10.2023.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i planifikuar buxhetor i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, mallra dhe shërbime.

4. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Caritas Kosova,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 053/26 Dt. 03.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e hartimit të projektit detal: "Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit", kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike-mallra dhe shërbime.

3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 051/26 Dt. 03.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 44 dhe 53 lidhur me nenin 49 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për anulim të vendimit

1. Anulohet në tërësi Vendimi nr. 01 nr. 533/25, i datës 10.09.2025, i cili ka të bëjë me lejimin e organizimit të transportit urban dhe transportit urban-periferik në Komunën e Prizrenit dhe zhvillimin e procedurave ligjore-shpallja publike për organizimin e këtij transporti.

2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Sektori i Prokurimit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 054/26 Dt. 04.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
## Për lejimin e shpalljes publike

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e organizimit të transportit urban dhe transportit urban-periferik në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet zhvillimi i procedurave ligjore-shpallja publike për organizimin e këtij transporti.

2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
  - Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 055/26 Dt. 06.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M
## Për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të anëtarësimit në SCI—Washington International Affairs Institute LL.C të qytetit të Prizrenit

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për pagesë të faturës të anëtarësimit në SCI—Washington International Affairs Institute LL.C, si anëtar global 1 vjeçar të qytetit të Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 3,990 $ (tremijë e nëntëqind e nëntëdhjetë dollar ).

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

3. Pjesë përbërëse e vendimit është fatura e 2026F0205001, datë 5 shkurt 2026.

4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 057/26 Dt. 09.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Eleonora Fetollari Buş-zyrtare e lartë për Integrime Evropiane, kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
## Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Eleonora Fetollari Buş-zyrtare e lartë për Integrime Evropiane në Komunën e Prizrenit, për lejimin e udhëtimit zyrtar me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë: "Hartimi i Masës Strategjike Rajonale për Ndërmarrësin e Grave" e cila organizohet në kuadër të Projektit: " E Ardhmja e Saj". Punëtoria do të mbahet nga data 10 shkurt 2026, deri me 13 shkurt 2026, në Ohër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurën, konform, akteve ligjore për Udhëtimet Zyrtare.

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

3. Obligohen Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurës,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 056/26 Dt. 09.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për lejimin e mjeteve financiare dhe udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e pjesëmarrjes së Komunës së Prizrenit-DTZHE në Panairin e Turizmit në Shqipërisë “Tourism Fair Albania -TFA26”, që mbahet në Pallatin e Kongreseve në Tiranë të Republikës së Shqipërisë nga data 11 shkurt 2026 deri me 12 shkurt 2026, si dhe mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në këtë panair dhe pagesa e mëditjeve. Kështu që, i lejohet Komunës së Prizrenit- DTZHE, pjesëmarrja në këtë organizim, si dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të pjesëmarrjes, lejohen mjetet financiare për:

    1.1. Pagesën e hapësirës për pjesëmarrje në shumën prej 1500.00 € (njëmijë e pesëqind euro) në emër të Kompanisë “Iceberg Exhibitions”.

    1.2. Mbulimin e shpenzimeve të akomodimit, të ushqimit dhe transportit për stafin pjesëmarrës të DTZHE-së në këtë panair,

2. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 10 shkurt 2026 dhe kthimi me 12 shkurt 2026.

3. Në këtë organizim të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi, udhëtimi zyrtar i pjesëmarrësve është në këtë përbërje: Adem Morina,-drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Sherife Çengaj-zyrtare për promovimin e Turizmit, dhe për të njëjtit lejohet pagesa e mëditjeve konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 dhe 2 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës– pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

5. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurëve,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 061/26 Dt. 12.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58, shkronja (e), dhe nenit 60, paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 03/2023 për Procedurën e Emërimit të Nënkryetarëve në Komuna, nenit 50 shkronja (e), 51 dhe 53 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01 nr. 058/26, datë 11.02.2026, të dorëheqjes së Kujtim Gashit - nënkryetar i Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M
# PËR LIRIM NGA DETYRA E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT

1. Kujtim Gashi lirohet nga pozita e nënkryetarit të Komunës së Prizrenit, i emëruar me vendim 01 nr. 001/26, të datës 05 janar 2026.

2. Lirimi nga posti i cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet pas kërkesës për dorëheqje të ofruar me shkrim 01 nr. 058/26, datë 11.02.2026, dhe zgjedhjes së të njëjtit deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës në zgjedhjet e mbajtura me 28 dhjetor 2025.

3. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, që duke u bazuar në këtë vendim, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe procedurale, që të heq nga lista e pagave Kujtim Gashin, nga data 12 shkurt 2026.

4. Obligohet Kabineti i Kryetarit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Kabinetit të Kryetarit të Komunës,
- Të lartcekurit,
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 064/26 Dt. 16.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 28 paragrafi 3 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Me këtë Vendim lejohet hapja e afatit për pranim të kërkesave për mbështetje financiare nga data 16.02.2026 deri me 30.11.2026, konformë nenit 27 dhe 28 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve.

2. Me këtë Vendim caktohet shuma e mjeteve për mbështetje financiare për kategoritë e përcaktuara në nenin 27 paragrafi 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5 dhe 2.6, të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, gjatë vitit kalendarik 2026, si në vijim:

   2.1. Për personat e sëmurë me sëmundje malinje-CA, lejohet mbështetja financiare në shumën 400,00 € (katërqind euro),

   2.2. Për personat e sëmurë me tumore inoperabile, tumore të trurit, tumore të pankreasit, tumore të mëlçisë, lejohet mbështetja financiare në shumën 400.00 € (katërqind euro),

   2.3. Për personat e sëmurë me tumore të tjera beninje, lejohet mbështetja financiare në shumën 400.00 € (katërqind euro),

   2.4. Për fëmijët e sëmurë me sëmundje neuromuskulare, sëmundje metabolike, diabet insulinvartës, defekte të lindura dhe të fituara të zemrës, si dhe fibrozë cistike, lejohet mbështetja financiare në shumën 400.00 € (katërqind euro),

   2.5. Për zyrtarët publik të Komunës së Prizrenit të sëmurë me sëmundje të rënda, siç janë sëmundje malinje-CA dhe intervenimet kirurgjike ne zemër (përveç stentimit), lejohet mbështetja financiare në shumën prej 30% të kostos së operimit, por jo më shumë se kufiri i përcaktuar sipas paragrafit 2 të nenit 27 të Rregullores nr. 001-011-201, datë 03.01.2024,

   2.6. Për personat e sëmurë me sëmundje të tjera të rënda, siç janë ciroza e mëlçisë (shkalla 3 dhe 4), kardiomiopatitë dillatative (shkalla 3 dhe 4), gjakderdhjet në tru dhe skleroza multiple, lejohet mbështetja financiare në shumën 400.00 € (katërqind euro),

3. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje financiare që do të pranohen nga Drejtoria e Shëndetësisë, gjatë vitit 2026, si dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
- Komisionit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 27 paragrafi 1 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datë 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave**

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar kundër vendimit të refuzimit për mbështetje financiare për vitin 2026. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

   1.1. Dr. Eshref Kryeziu, specialist i mjekësisë familjare,.....nga QKMF, kryesues,
   1.2. Fatlinda Ukaj, zyrtare e lartë ligjore, ....................................nga DSh, anëtare,
   1.3. Bardha Kastrati, zyrtare e lartë për statistika shëndetësore....nga DSh, anëtare,
   1.4. Driana Destani, zyrtare për buxhet dhe financa,.....................anëtare rezervë,

2. Detyrat e Komisionit, të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi janë që një afati sa më të shkurtër kohor të bëjë:

   2.1. Shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave kundër vendimit të refuzimit për mbështetje financiare për vitin 2026, konform Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve.

   2.2. Marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me aprovimin dhe refuzimin e mbështetjes financiare bazuar në ankesat e trajtuara.

3. Mandati i Komisionit do të zgjat deri me 31.12.2026.

4. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Komisionit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 065/26 Dt. 16.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 27 paragrafi 1 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje financiare që do të pranohen nga Drejtoria e Shëndetësisë gjatë vitit 2026. Anëtarë të këtij Komisioni, emërohen:

   1.1. Dr. Florije Avdylaj, specialiste e mjekësisë familjare,.....nga QKMF, kryesuese,
   1.2. Fatlum Berisha, zyrtar për shëndetësi, .......................nga DSh, anëtar,
   1.3. Qendresa Racaj, zyrtare ligjore,.................................nga DSh, anëtare,
   1.4. Shpejtim Rramanaj, udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi,.. anëtar rezervë,

2. Detyrat e Komisionit, të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, janë që në afat sa më të shkurtër kohor të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, të cilat i drejtohen Drejtorisë së Shëndetësisë për mbështetje financiare konform Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve.

3. Komisioni përzgjedh aplikacionet që i plotësojnë kriteret për mbështetje financiare sipas rregullores përkatëse dhe, përmes Drejtorisë së Shëndetësisë i propozon Kryetarit të Komunës miratimin e mbështetjes financiare.

4. Komisioni i propozon Drejtorisë së Shëndetësisë refuzimin e aplikacioneve që nuk i plotësojnë kriteret e parapara konform rregullores.

5. Mandati i Komisionit zgjat deri më 31.12.2026.

6. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Komisionit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 067/26 Dt. 16.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e realizimit të projektit "Shqyrtimet laboratorike për projektet e investimeve kapitale", kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor Mallra dhe Shërbime – Kontratë Kornizë tre (3) vjeçare.

3. Ky projekt realizohet sipas kodit buxhetor-mallra dhe shërbime të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Sektorit të Prokurimit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 063/26 Dt. 16.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datë 15.10.2008, pas kërkesës 01-030 nr. 18931, datë 12.02.2026, të parashtruar nga Dijar Emini, kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M
## Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 18931, datë 12.02.2026 e parashtruar nga Dijar Emini, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për kremtimin e Festës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve rreth këtij kremtimi (organizimi), lejohen mjetet financiare në shumën prej 250.00 € (dyqind e pesëdhjetë euro).

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 075/26 Dt. 23.02.2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58, shkronja f, të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 8, paragrafi 1 dhe paragrafi 5.3 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
## PËR LIRIM NGA DETYRA E ASISTENTIT ADMINISTRATIVE NË ZYRËN NËNKRYETARIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT

1. Granit Shosha, lirohet nga pozita si asistent administrativ në Zyrën e Nënkryetarit të Komunës së Prizrenit, i emëruar me vendim 01 nr. 12/26 të datës 09 janar 2026.

2. Obligohet Granit Shosha, që të bëj dorëzimin e mjeteve të punës dhe dokumentacionit përkatës zyrtar tek Kabineti i Kryetarit të Komunës së Prizrenit.

3. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, që duke u bazuar në këtë vendim, të i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe procedurale, që të heq nga lista e pagave Granit Shoshen, nga data 16 shkurt 2026.

4. Obligohet Kabineti i Kryetarit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, i lartcekuri dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Kabinetit të Kryetarit të Komunës,
- Të lartcekurit,
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 084/26 Dt. 26-02-2026

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, Memorandumit të Bashkëpunimit (bashkëfinancimi) të lidhur ndërmjet "Innovation and Training Park-Prizren (ITP), Komunës së Prizrenit dhe "Makerspace- Innovation Center Prizren", 01 nr.073/26, datë 20.02.2026, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datë 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
### Për lejimin e mjeteve financiare për bashkëfinancim të projektit

1. Lejohen mjetet financiare për bashkëfinancimin e realizimit (financimin) të projektit: "Digital Innovation Geteway for Kosovo-DIG4K" ("Porta e Inovacionit Dixhital për Kosovën''), i cili bashkëfinancim bazohet në nenin 3.1 (obligimet e palëve) dhe Aneksit 1 (detajet e financimit) të Memorandumit të Bashkëpunimit (bashkëfinancimi) të lidhur ndërmjet "Innovation and Training Park-Prizren (ITP), Komunës së Prizrenit dhe "Makerspace- Innovation Center Prizren", 01 Nr.073/26, datë 20.02.2026, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare si në vijim:

    1.1. Për Programin 1, lejohen mjetet financiare në shumën 28.500,00 €,
    1.2. Për Programin 2, lejohen mjetet financiare në shumën 30.000,00 €,
    1.3. Për Programin 3, lejohen mjetet financiare në shumën 52.000,00 €,
    1.4. Për Programin 4, lejohen mjetet financiare në shumën 45.500,00 €,
    1.5. Për Programin 5, lejohen mjetet financiare në shumën 32.000,00 €.

2. Shuma e përgjithshme që lejohen është 188,000.00 € (njëqind e tetëdhjetë e tetëmijë euro).

3. Zyrtar monitorues i projektit nga Komuna e Prizrenit caktohet Halil Lika.

4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit (bashkëfinancimi) i lidhur ndërmjet "Innovation and Training Park-Prizren (ITP), Komunës së Prizrenit dhe "Makerspace- Innovation Center Prizren", 01 Nr.073/26, datë 20.02.2026.

5. Shuma e lejuar me këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës, dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.

6. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe zyrtari monitorues për zbatimin e vendimit.

7. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Makerspace Innovation Center,
- ITP,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

